




**KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË
SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA**



Procesverbal X/2024

**I mbajtur me rastin e mbledhjes së 10 (dhjetë) për vitin 2024 të Kuvendit të Komunës
së Suharekës**

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 31.10.2024
Ora: 10.00

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci
Z. Selman Kolgeci
Z. Flamur Bytyqi
Z. Urim Suka
Z. Kushtrim Kuçi
Znj. Elmaze Bytyqi
Znj. Bulëza Kuçi
Znj. Doruntina Zenelaj
Z. Alban Berisha
z. Xhevshet Gashi
Z. Bexhet Kuçi
Z. Reshat Selimaj
Z. Lirim Qatani
Z. Aziz Bytyqi
Znj. Sanie Kuçi-
Rexhepaj
Znj. Fidaije Kukaj

Znj. Afërdita Morina
Z. Vullnet Luzhnica
Z. Edon Sadikaj
Znj. Saranda Bajraktari
Znj. Mimoza Bajraktari
Znj. Festë Kabashi
Z. Dardan Berisha
Z. Bajram Basha
Znj. Mevlude Kabashi
Znj. Sheqerije Zyrapi
Znj. Laureta Tafaj
Z. Liridon Fandaj
Z. Qëndrim Elshani
Z. Herolind Limaj
Znj. Jehona Lumi-
Rrafshi

Të pranishëm tjerë:

Kryetari Komunës
Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI
Znj. Habibe Bytyqi
Z. Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili propozoi këtë:

REND DITE

1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit;**
3. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm;**
4. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-56304;**
5. **Informatë për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-shtator 2024;**
6. **Pyetje dhe përgjigje;**

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet rendi i ditës

Kryesuesi - para se të fillojmë me pikat e rendit të ditës ia jap fjalën Drejtoreshës së Kulturës.

Lorika Gashi - përshëndet të pranishmit.Sot qëndroj para jush me ndjenja të përziera të një krenarie të madhe për arritjet tona të përbashkëta.Këto tri vite kanë qenë për mua një përvojë inspiruese në pozitën e Drejtoreshës për DKRSM.Sot jam para jush për t'ju njoftuar që tashmë kam kërkuar nga Kryetari i Komunës z.Bali Muharremaj për të më liruar nga detyra.Pra kjo është dita ime e fundit në krye të detyrës të kësaj drejtorie për këtë mandat.Ka qenë nder i madh të shërbej për qytetin dhe qytetarët tonë andaj ndërsa po e përfundoj këtë kapitull dua ti ndaj me ju disa prej arritjeve tona dhe ti falemderoj nga zemra të gjithë ju që ishit pjesë e këtij rrugëtimi.Drejtoresha përmend të gjitha të arriturat që janë bërë gjatë mandatit sa ka qenë drejtoreshë e kësaj drejtorie dhe thotë që gjitha sukseset dhe punët e mira për qytetin dhe qytetarët nuk do të ishin të mundura pa përkrahjen dhe bashkëpunimin tuaj.Drejtoresha në fund falemderon Kryetarin e Komunës z.Bali Muharremaj për besimin e dhënë në fillim të këtij mandati që të udhëheq me një drejtori shumë dinamike dhe gjithëashtu falemderon gjithë tjerët.

Kryesuesi - falemderon drejtoreshën për bashkëpunimin dhe në emër të Kuvendit i uron suksese.

Nënkryetari - përshëndet të pranishmit.Në emrin tim,në emër të zyrës së Kryetrit,në emër të drejtorëve e falemderoj për zemërsisht drejtoreshën Lorika Gashi për punën dhe angazhimin që e ka dhënë deri më tani.I uroj drejtoreshës shëndet e punë të mbarë kudo që të punosh e veprosh dhe falemderit për bashkëpunimin dhe energjinë që ke shpenzuar për gjithë projektet që t'u kanë besuar ty.

Dardan Berisha - përshëndet të pranishmit.Në emër t'imin dhe në emër të gjithë asambleistëve të PDK-së i dëshirojmë drejtoreshës shëndet dhe suksese në jetën e saj.

Urim Suka - përshëndet të pranishmit.Ne kemi pas tri vite bashkëpunim,kritikë,angazhim,ballafaqim idesh e mendimesh të përbashkëta dhe jemi pajtu e s'jemi pajtu.Drejtoresha foli më shumë për sukseset,siç dihet ka pas edhe shumë vështirësi kjo drejtori dhe ngecje në fushën e vet por si do që të jetë jemi në një moment ku kjo e len detyrën dhe ne në emër të grupit të LDK-së i uroj sukses.

Qëndrim Elshani - përshëndet të pranishmit.Me Drejtoreshën e Kulturës kemi pas diskutime të shpeshta në sallën e Asamblesë por besoj që ato diskutime kanë qenë për të mirën e qytetarëve.E përgëzoj drejtoreshën dhe më vje mrë që i falemderoj djemtë më besnik të qytetit siq janë gjebrailat në fjalimin e saj dhe në emër të LVV-së i urojmë suksese në hapin tjetër që do ta merr në karrierë.

Aziz Bytyqi - përshëndet të pranishmit.Fjalimi yt emocional ma krijoi një përshtypje që është reale dhe e vërtetë sepse e ke bërë këtë punë me zemër, përkushtim e shumë profesionalizëm dhe të përgëzoj.Të

falemderoj për bashkëpunimin dhe definitivisht për mua dhe për gjeneratat e reja je një model i suksesit.Të uroj suksese dhe shëndet.

Jehona Rrafshi Lumi - përshëndet të pranishmit.Në emrin tim personal dhe të partisë NISMA i dëshiroj suksese Lorikës në rrugëtimin e saj personal dhe u shtofshin njerëz punëtor dhe të mirë si ti.

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe kërkon nga subjektet politike që ti propozojnë emrat e tyre.

Aziz Bytyqi - Fidaie Kukaj.

Urim Suka - grupi i LDK-së nuk merr pjesë në këtë komision.

Sheqerie Zyrapi - PDK propozon Dardan Berishën.

Qëndrim Elshani - LVV nuk ka propozim.

Jehona Rrafshi Lumi - Nisma nuk ka propozim.

Kryesuesi - kërkojmë edhe një emër nga legjislativi.

Aziz Bytyqi - Reshat Selimaj.

Dardan Berisha - propozoj Jehona Rrafshi.

Kryesuesi - Jehona Rrafshi deklarohet që nuk do të marrë pjesë në komision.

Kryetari - nga ekzekutivi propozon Sinan Vrella dhe Vjollca Hoxhaj.

Kryesuesi - e hedh në votim komisionin me këtë përbërje:Fidaie Kukaj,Dardan Berisha,Reshat Selimaj,Sinan Vrella dhe Vjollca Hoxha.

16 për,9 apstenime, Miratohet pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Shefket Kolgeci - përshëndet të pranishmit.Kërkojmë sqarim më të mirë nga Drejtoria e Pronës se prej ku dhe nga sepse shumica nuk e dimë ku është dhe besoj duhet me përgadit ndonjë sllajt për mbledhjet e ardhshme të Asamblesë dhe gjithëashtu arsyen.

Selman Kolgeci - parcela 656-0 që është pronë publike nuk e di çka ka m'i shërby operatorit ekonomikë dhe a ka me u lidh ndonjë rrugë tjetër me këtë rrugë dhe cila është pjesa që komuna ka me përfitu prej tri parcelave të pronarit privat?

Sanie Kuçi Rexhepaj - përshëndet të pranishmit.Kjo pikë në KPF ka ardhë jasht rendit të ditës ku me shumicë të votave kolegët asambleist u pajtuan që të diskutohet në Asamble.Më vje keq drejtor por kjo pikë e rendit të ditës është e pakompletuar.Atë ditë ti na dhe një sqarim mirëpo nuk patëm asnjë dokument përpara që ne me analizu dhe tash kur na erdhë materiali për Adamble,ti nashta the: i kam 50 letra përpara që jam duke i sqaru por neve na kanë ardhë ndoshta 5 apo 6.Ku janë letrat tjera ku ti tash i paske përpara vetes por neve nuk na ke dërgu? Neve na kanë ardhë skicat e terenit por nuk po specifikohet qartë cilat pjesë janë që me u pajtu ne a me i shpall interes të përgjithshëm apo jo.Ne si KPF ta dhamë një mundësi për me u disku kjo pikë e rendi të ditës në Asamble mirëpo mendoj që duhet me pas aq respekt për Kuvendin Komunal që të paktën atë mundësi me shfrytëzu dhe me kompletu lëndën kur t'na bje neve.Aq më tepër neve na ka ardhë një kërkesë që kur e lexova vetëm rreshtin e parë,si asambleiste pak u ndjeva e ofenduar.Po e citoj kërkesën:DSHPJK ka pranuar një kërkesë nga pala ... me numër prt ...të datës .. për këmbimin dhe ndërrim të pronës për nevoja të zgjidhjes urbane.Serioziteti në këtë rast më duket zero.Fundi i shkresës: të bashkangjitur gjeni kërkesën e pales -të cilën nuk e kemi të bashkangjitur;

propozim skicën nga tereni -nuk e kemi të bashkangjitur; qertifikatat e pronës -na keni bashkangjitur;njoftim nga Drejtoria e Urbanizmit- nuk na ke bashkangjitur.Propozimi im është: të lutem tërhiqe këtë pikë të rendit të ditës dhe na sill në Asambleenë e ardhshme por të lutem që të jetë e kompletuar në mënyrë që ne me marrë vendim të drejtë për shkak se jemi duke diskutu për çështje të pronave.

Armend Krasniqi - përshëndet të pranishmit.Miratimi i HZK-së nga komuna e Sharekës ka krijuar një rregull se si duhet të zhvillohet komuna e Suharekës.Po befasohem me ingjiniere Sanie Kuçi Rexhepaj sepse faktikisht kjo duhet m'i mbështet shumë më shumë këto procese të cilat i ndërmerr komuna dhe jo ti arsyetoj me një qasje kësi soji.Unë po mendoj që edhe ne jemi duke gabu sepse e kemi interesin e përgjithshëm në momentin që e kemi votu HZK-në dhe faktikisht e kemi specifiku ku duhet me u hap rrugët,ku duhet me u ndërtu shtëpitë njëkatëshe e dykatëshe dhe ndërtesat 5 katëshe apo 6 katëshe.Ne në bazë të një kërkesë e cila na ka ardhë nga një kompani e ndërtimit,kemi pa që komuna fiton shumë nëse e praktikon dhe e realizon këtë kërkesë sepse ne me eksoficio duhet të marrim iniciativë për hapjen e rrugëve të cilat e kemi parapa me Hartën Zonale mirëpo për shkak të mungesës së stafit dhe mungesës së buxhetit ne nuk mund ti përfundojmë të gjitha planifikimet të cilat i kemi parapa me HZK,gjë që e kemi obligative që ti marrim vet këto iniciativa.Andaj duke mos i marr vet këto iniciativa neve po na ndihmojnë edhe kompanitë e bizneseve dhe qytetarët e thjeshtë ku po dojnë me hy në këmbim me neve.Me seriozitet të lartë,apsolutisht asnjë pike që nuk e shoh që nuk është në interes të përgjithshëm,kurrë as që mendoj me marrë iniciativë.Kjo është interes më shumë se sa jetik i komunës së Suharekës të realizoj këso projekte.Kërkoj nga ju ta shtyni përpara.Sanie për ato me pika pika,ishte një kritikë me vend sepse ka ndodh për gabime teknike.

Sanie Kuçi Rexhepaj - drejtor ,fjalimi im nuk ishte për me diskutu përmbajtjen e pikës që na ke sjellë.Nëse juve ju drejtohet një palë me një kërkesë dhe lënda është e pakompletuar,a i lëshon vendim apo kërkon plotësim lënde?

Armend Krasniqi - ne i kemi kërku vetëm ato gjëra të cilat i kërkon ligji në fuqi.I kemi kërku skicën,i kemi dërgu qertifikatat dhe kërkesën të cilën duhet të kalohet.Për çdo paqartësi tjetër unë jam në gjendje me sqaru.Vet keni punuar në hartimin e HZK-së dhe më mire se çdo njëri këtu e dini se si duhet të zbatohet HZK-ja.Mua më vje keq që një ish drejtoreshë e Urbanizmit,me ra në këtë diskutim.Unë nuk di të tjerët si mund ta kuptojnë këtë gjë.

Sanie Kuçi Rexhepaj - kur ju drejtor jeni serioz mjaftueshëm me na sjell një lëndë të kompletuar në Kuvend Komunal atëherë mund të diskutojmë për rëndësinë e lëndës që ke sjell përndryshe për një lëndë të pakompletuar nuk besoj që ka arsye Asambleja me diskutu sepse është e paqartë dhe jam e sigurt që 90% e asambleistëve nuk e ka kuptu që cila pjesë ka me u këmbu me cilën pjesë.Nëse ju jeni jo serioz,merrne përgjegjësi dhe tërhiqeni këtë pikë të rendit të ditës për shkak se është përtej qesharakes.

Armend Krasniqi - miratimi HZK-së e ka shpall interesin e përgjithshëm të komunës së Suharekës andaj ne me një vendim shtesë po dojmë me fuqizu atë për shkak dhe është mirë me na interpretu edhe zyrtari ligjor.Neve na ka ardhë një palë e cila është e interesuar me dhënë 221 m² prej pronës së vet dhe nëse sot nuk jemi në këmbim,ne kemi me pagu këtë dhe plus kemi me pagu shtëpitë të ciat i ka në atë parcellë.

Selman Kolgeci - drejtor a mund të na sqarosh saktë cilën pjesë jemi duke e dhënë dhe cilën pjesë jemi duke e marrë.Ne padyshim jemi për me zbatu HZK-në por nuk e kemi të qartë se cilën pjesë të parcelës së vet është duke e nda për me hap rrugë.

Armend Krasniqi - ngjit janë parcellat dhe nga tri pjesë të parcellave kemi me i marrë nga disa m² katrorë ndërsa me një parcellë të komunës kemi me i dhënë 221 m².

Selman Kolgeci - faktikisht po i bie që rruga Aleksandër Moisiu lidhet me rrugën Vudro Vilson.

Kryesuesi - po.Ia jep fjalën zyrtarit ligjor.

Avni Bytyqi - siq e tha drejtori,ligji për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme e jep mundësinë që të këmbehet prona publike me pronën private dhe të jep mundësinë që prona private me pronën publike të këmbehet edhe me kërkesën e palës kur prona është në kufirin kadastral për të cilin këmbehet. Në këtë rast pronat janë në kufirin kadastral dhe ne po e fillojmë një procedurë dhe sipas ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme thuhet: kur fillohet procedura për këmbimin e pronës private me pronën publike së pari duhet të shpallet prona private interes i

përgjithshëm nëse me Hartë Zonale apo me Plan Zhvillimor nuk është e rregullune një çështje. Drejtori e potencoi që kjo çështje është e rregulluar me HZK që në këtë rast fare nuk kemi pas nevojë që të shpallim interes të përgjithshëm por për hir të korrektësisë dhe të ju njoftojmë juve si kuvend. Deri në këtë moment procedurat janë ligjore dhe i ka ndjek drejtori sipas ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme.

Çështjen e vlerësimit e bën komisioni i themeluar në Ministrinë e Financave.

Urim Suka - në takimin që kemi pas në KPF ne nuk kemi pas asnjë dokument përpara dhe për deri sa nuk kemi pas dokument përpara unë kam thënë që s'mund ta ngris dorën.Me pas qenë drejtori më i përgjegjshëm,ish përgadit me kohë dhe e kish sjell edhe në KPF dhe këtu.Ne në parim jemi për me i dhënë përkrahje por pse është kjo situatë kështu? edhe atë drejtori përgjegjet që i jep,del prej kontestit prej asaj çka ne po themi.Për deri sa vendimin ka me marrë kuvendi,kuvendi duhet me u njoftu në detaje ku secili asambleist duhet me ditë se për çka po e qon dorën e pastaj me vendos a duhet me qenë kundër apo për.Duke marrë shkas nga mbledhja e KPF-së dhe nga diskutimet që ishin këtu e nga materialet që kemi përpara ku një çështje e tha edhe Sania,ku ti e ke një kërkesë ku nuk specifikon asgjë.Te pjesa e parcelave po shkruan: nga parcela 6492 merret një pjesë por në skicë askund nuk po shkruan cila pjesë merret.

Besojmë që nuk është fare e përgaditur dhe nëse e votojmë për në këto rrethana, mendojmë që mujna me gabu dhe e kemi të vështirë me dhënë mbështetjen.Po ashtu nuk po e kuptoj emergjencën për me ardhë një pike kaq shpejtë.Nëse ka ndonjë emergjencë që po ikën naj afat që dikush mundet me na thënë që duhate ta bëjmë patjetër se unë marrë obligim se këto gjëra teknike i rregulloj dhe ju njoftoj dhe pas fjalës që tha Avniu,nëse doni e japim përkrahjen nëse ka garanci.Dua sqarime plus pse qenka kaq emergjente.

Kryesuesi - për dallim nga KPF-ja që kemi pas edhe unë pajtohem me ty dhe me Sanien mirëpo thash është sjell edhe kopja e planit dhe qertifikata e pronave dhe në aspektin teknik është më e kompletuar.

Armend Krasniqi - Urim bisedo me Kolgecin dhe ai të tregon çka është kjo dhe nuk ke nevojë me bo tragjedi dhe komedi për një gjë që zyrtari ligjor tha që kjo sipas dokumenteve të kërkuara,sipas ligjit për këmbim dhe dhënie në shfrytëzim të pronave komunale është çdo gjë në rregull dhe për deri sa thotë zyrtari ligjor që është çdo gjë në rregull pse po marrim qindra hamendësime.Çdo herë po më bind që e ke marrë një pozitë në LDK që nuk e ke meritë.

Urim Suka - drejtori prap nuk ma kthej përgjigjen se cila është emergjenca.Gjithë këtë energji që drejtori pe hargjon për me na kthy neve përgjigje politike për një çështje që është profesionale e tij,është gabimi i vet që po e bën.Ky duhet me hargju energji se paguhet për çështje profesionale,me kompletu lëndën që unë mos me pas dilema fare.Unë thash po du me votu por trego cila është emergjenca dhe ky prap nuk tregon cila është emergjenca dhe më bën politikë mua.

Armend Krasniqi - unë e thashë që sa më shpejt që të zgjidhet një problem për komunën është në interes të komunës.Kur the ti që kjo është çështje profesionale,si me i tregu profesionisti amaterit ? Unë po të tregoj profesionalisht që kjo është sjell në mënyrë ligjore.

Urim Suka - pajtohem me drejtorin,Po unë jam amater por unë kam me marrë vendimin dhe amater si unë në fushën e katastroës jena shumica e asambleistave dhe për atë që jam amater për deri sa po du me qu dorën,po du sqarime prej drejtorit dhe në as një rast nuk më dha përgjegje.

Liridon Fandaj - e përgëzoj drejtorin që më në fund edhe Kryetarit i tregoj që kur është interes i përgjithshëm duhet me punu për interes të përgjithshëm e jo me shtru rrugë e masanej me na kushtu ma shtrenjtë sepse Kryetari e ka bërë këtë punë që unë po hapi rrugë por po ia rriti vlerën tokës por neve ka me na kushtu edhe vite e vite nëpër përmbarues.Te pika e kam përkrah edhe atë ditë por kërkoj një sqarim se a ka me ndodhë që çdo kund ku është prona publike dhe private dhe nëse është interes i përgjithshëm,a ka me u këmbu apo ka me shku me shpronësim? Nuk është hera e parë që na vjen një pikë shtesë e rendit të ditës siç na ka ardhë në KPF por më duket edhe ju si ekzekutiv e keni marrë pak që po punon drejtori shumë dhe duhet me ia prish pak.

Armend Krasniqi - faleminderit.Sa i përket pyetjes,aty ku ne kemi parcella që na konvenojnë ku mujna me marrë dhe me dhënë,për mos me dhënë pare komuna dhe mos m' u dëmtu financiarisht,është mirë që me shfrytëzu maksimalisht këtë mundësi që e kemi dhe një ndër pikat më kryesore është kjo.

Selman Kolgeci - meqenëse është interes publik,pse s'po provon drejtori me dal në foltore,me na sqaru dhe me na bind të gjithëve.Unë për vete e kam të qartë.Sa është dëmi që dëmtohet ?po e potencon 300.000€.

Kryesuesi - ky e tha hipotetakisht.

Armend Krasniqi - drejtori del në foltore dhe jep sqarime sipas skicës ku thotë që janë tri parcela në pronë private që komuna ka punu shumë për me planifiku zhvillimin komunal ,e ka bërë që këtu me qel rrugë komuna dhe ne duhet me shku me hap këtë rrugë edhe nëse nuk hymë në këmbim.Investitori ka thënë që mos ti marrë pare komunës por interesi i komunës është që unë me marrë këtë pjesë dhe me ja dhënë pjesën që ju vet po doni me ma marrë.Nga tre parcela ne i marrim 221 m² dhe i japim 221 m² dhe ministria e bën vlerësimin.Drejtori tutje jep sqarime.

Sanie Kuçi Rexhepaj - zyrtar ligjor a mendoni që MAPL-ja,me dokumentacionin që na ka ardhë neve si Asamble e shqyrton këtë kërkesë nga ana e jonë apo duhet edhe atje drejtori me shku dhe me dal në foltore me e prezantu?

Avni Bytyqi - sipas ligjit për vetqeverisje lokale, Kuvendi pas miratimit të vendimeve është i obliguar që ti dërgon në MAPL-së për shqyrtim të ligjshmërisë vetëm vendimet që miratohen nga Kuvendi mirëpo ne kohëve të fundit sipas praktikave të të gjitha komunave,ne ia bashkangjtim edhe qertifikatën dhe kopjen e skicës së terenit dhe është e mjaftueshme për ministrinë e pushtetit lokal për ta bërë shqyrtimin e ligjshmërisë së këtij vendimi po që se nuk kërkohet ndonjë plotësim ndryshim apo ndonjë plotësim të lëndës nga ministria sipas rregullores për shqyrtimin e akteve administrative dhe nëse kërkon munistria me dhënë sqarime,e qojmë edhe drejtorin.

Alban Berisha - lidhur me pikën,pavarësisht qëllimit që ne nuk po dyshojmë në qëllimin tënd dhe edhe ne si asambleista e kemi dhënë një betim që kemi me mbrojt interesin e përgjithshëm dhe do të mundohemi në maksimum,unë nuk e ndëgjova këtu asnjë fjalim që ishte kundra ose e vuri në dyshim qëllimin e vendimit tuaj dhe e dimë që është një qëllim i mirë.Po e shoh një tendencë tënden drejtor që nuk po më pëlqen,që nëse dikush ka me kërku diçka administrative,ti direkt po shkon te objekti kryesor me thënë që qëllimi është i mirë dhe pse s'po e votoni.Pas kësaj pike ne e kemi një vendim për me shfuqizu dhe ajo është një lëshim prej drejtorisë tënde.Të kam thënë edhe ty dhe Kryetarit që nganjëherë numri i madh i votave me shumicë kur i ke në Asamble,të qet në pozicion të lajthitjes.Unë ndihem keq sa herë ka vendime për shfuqizim sidomos për gabime procedurale ose mos plotësim të dokumentacionit.Drejtor mos u kthe me thënë që është vendim i mirë sepse ne askush nuk jemi duke e dysu dhe duhet me vazhdu sepse në rregull është me bërë këmbime.I ke sjell disa skica dhe nuk do të thotë që krejt e kemi gjiroportalin në kokë dhe si ta shkruan numrin e parcellës,ne e dimë saktë se ku është.Pse mos me bashkangjit në email skicën sepse edhe dokumentat që i ke shkru të bashkangjitura,ti nuk i ke.Te numrat e votave e di që të kalojnë vendimet por kisha pas dëshirë me qenë shumë më i përgaditur me dokumentacion dhe mos t'na kthehen vendimet prej MAPL-së.

Armend Krasniqi - mirë e elaborove më në fund sepse u bërë një polemikë.Sa i përket dokumentacionit,dokumentacionin e vendos vetëm zyra ligjore.Në përputhje me ligjin,ato dokumenta që janë kërku,ato janë marrë nga zyra ligjore dhe kanë shku tutje.

Avni Bytyqi - sa i përket plotësimit të dokumentacionit është përgjegjësi e Drejtorisë së Pronës dhe nuk është përgjegjësi e zyrës ligjore dhe as e Kryetarit të Komunës. Si ka ardhë kërkesa ne ia kemi dërgu. Më pëlqej propozimi që e dha Selmani. Realisht në kërkesë nuk është shkruar fare qëllimi se për qka fillon procedura e kembimit, përpos që unë kam bisedu me Drejtorin e Urbanizmit i cili është prezent dhe Drejtori i Urbanizmit ka thënë që bëhet hapja e rrugës Vurder Wilson dhe sipas Selmanit po del lidhja e rrugës Vildon Vilson me Aleksandër Moisiu. Në këtë rast ne për këtë vendim duhet me cek që rregullimi i infratrakturës rrugore me rrugën vildon vilson me Aleksandër Moisiu dhe atëherë ky vendim e merr formën e kompletuar dhe mund të vazhdoj tutje. Mos mendoni t'ia gjuani fajin atij ose këtij por secili për pjesën e vet le ta ban përgjegjësinë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

**26 për,1 kundër,2 apstenime
Miratohet pika 3**

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-56304;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - Drejtoria në fjalë e ka harru këtë pronë dhe nuk e ka fut në listën e pronave të veçanta për komunën tone dhe si rezultat i asaj tash është kthyer vendimi. Kontrata e kësaj deponie i ka skaduar në korrik dhe ne po diskutojmë në muajin nëntor dhe jemi vonë si ekzekutiv. Ekzekutivi duhet të nis procedurat 3-4 muaj përpara që kur të vije koha e skadimit të kontratës, me pas gati një kontratë tjetër. Si rezultat i kësaj dhe vendimit të shpejtë që ne e morëm muajin e kaluar dhe tash është kthyer, për shkak të paaftësisë për me i kry punët si duhet, drejtorit të katastrofës në këtë rast dhe përgjegjësisë si ekzekutiv, komuna e Suharekës nuk e ka një deponi legale. Për deri sa është kthyer prej Ministrisë ne jemi për me shfuqizuar.

Armend Krasniqi - është e vërtetë që është kthyer një pikë e re në ditën të cilën e kemi kaluar në Asamblenë e kaluar nga Ministria për shkaqe të mos publikimit të listave të veçanta të pronave për dhënie në shfrytëzim. Ne i kemi dy lista të publikuara dhe një të re e kemi me prona të përgjithshme dhe njëra që duhet të jetë lista e veçantë me rreth 100 prona. E pranojmë si faj mos publikimin në listë të veçantë për dhënie në shfrytëzim të pronave. Nga disa diskutime që i kemi pas në të kaluarën me ekspertë kemi konstatuar që deponia ekzistuese është pothuaj në fazën e mbushjes dhe më nuk ka vend të mjaftueshëm për ti hudhur mbeturinat e ngurta. Ne duke kërkuar një mundësi tjetër për qytetarët por në pamundësi dhe në mos përpuethshmëri me HZK-në nuk kemi mujt me gjet asnjë vend tjetër ku mundemi me i hudh këto mbeturina andaj kemi provuar ta sjellim në Asamble në mënyrë që të krijojmë edhe një alternativë tjetër për 1 ose 2 vite por fatkeqësisht nuk është pranuar nga ministria përkatëse për shkak të defekteve ligjore.

Liridon Fandaj - prej mandatit që e keni filluar, jeni kampion për kthimin e vendimeve. 35 vendime janë kthyer. Secila drejtori e ka një jurist dhe para se me i sjell këto vendime do të duhej në secilën drejtori juristi me pa a ja vlen me qu a jo e pastaj te zyra ligjore me përgadit si vendim. Ndoshta nuk është krejt faji i drejtorit por është mos puna e stafit brenda drejtorisë që i kompletton dokumentet dhe me qu te zyra ligjore. Ne jemi për me shfuqizuar.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

16 për, Miratohet pika 4

Pika 5. Informatë për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-shtator 2024;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe hap debatin.

Labinot Halitjaha - komuna e Suharekës e ka bërë një shpenzim të mirë të buxhetit për vitin 2024 afërsisht 80 % të buxhetit të përgjithshëm ndërsa te investimet kapitale ka shku afërsisht 60%. Të hyrat vetanake këtë vit janë thuajse mirë në krahasim me vendimin që ka marrë qeveria dhe Asamblea për faljen e tatimit në pronë.

Urim Suka - drejtori tha që këtë vit shpenzimet kanë shku më mirë. Ajo 60% në dokumente është 54 % për investime kapitale por edhe është 54 për faktin që e dimë se çka ka ndodhur me buxhetin këtë vit. Tash i ka marrë përmblyesit ato pare dhe ju po doni me i kthyer që i keni shpenzuar. Mënyra se si është shpenzuar buxheti për mua ka qenë jo e drejtë dhe vazhdimisht i kemi dhënë shqetësimet tona, kritikën tona për atë dhe kjo e këtij viti është pak përzierje e kompetencave sepse e dime që kontrata kolektive rrjedh nga qeveria por disa nga ato komuna ka mujt me i përmbush sidomos te pjesa e transportit të mësimdhënësve ku ka marr vet obligim që ka me e përmbush transportin e mësimdhënësve por nuk i ka kry ato obligime ose te pjesa e pagës jubilarë. Unë dua ta kem një përgjigje për disa shpenzime që mua mu duken të mëdha por nuk dua të paragjykoj sepse ndoshta janë në të mirë të komunës. Fjala është për shpenzimet që janë bërë për udhëtime zyrtare jasht vendit. Në bazë të një kalkulimi të disa drejtorëve, rreth 38.000 € janë shpenzuar për udhëtime zyrtare jasht vendit deri në këtë periudhë që po flasim, sidomos kampioni shpenzimeve për udhëtime jasht vendit është Drejtoria e Urbanizmit 9,106€ pastaj QKMF-ja më bëri përshtypje me 4,455€. Shërbimet Publike 3,800€, Administrata 5,800€, Drejtoria e Arsimit 7,000€. Dua ta di nga secili që i ka bërë këto shpenzime, cili ka qenë qëllimi i këtyre vizitave? Çka ka përfituar komuna nga këto vizita? Cili ka

qenë kriteri i përzgjedhjes së delegacioneve që kanë përfaqësuar komunën në këto vizita? Sa nga këto mjete që janë shpenzuar kanë qenë meditatje që i kanë marrë personat që kanë bërë këto vizita?

Enver Shabani - përshëdet të pranishmit. DSHPME i ka shpenzuar 3800€ për dy qëllime dhe dy arsye. Qëllimi i parë ka qenë udhëtimi në Gjermani me dy zjarrefikës për marrjen e një automjeti për shuarjen e zjarreve në lartësi. Vlera e kamionit ka qenë 16.800 € kurse shpenzimet tona kanë kaluar shifrën 3000€ kurse ne i kemi shpenzuar 3400€ dhe 400 nuk i kemi marrë kurrë prej komunës. Drejtori tutje jep sqarime dhe thotë që 50€ i kemi marrë meditatje dhe të gjitha janë të faturuara dhe të dëshmuara. Kurse 800€ i kemi marrë për një takim të përbashkët në komunën e Laqit në Shqipëri para një muaji ku e kemi pas një projekt të përbashkët me bashkësinë evropiane për efikasitet që në këtë rast ne i kemi përfutur 54.000€.

Besa Kuçi - shpenzimi prej 4445€ udhëtime zyrtare jashtë vendit është një njësi e planifikuar në kuadër të zhvillimit të vazhdueshëm profesional për profesionistët shëndetësor dhe natyrisht meditatje nuk marrin.

Remzi Bajselmani - unë konkretisht nuk e di saktë si kanë shkuar as shpenzimet dhe as udhëtimet.

Urim Suka - më shqetëson përgjigja e drejtorit që tha nuk e di dhe është mirë me marrë informata se ku kanë shkuar parat. Falemnderoj drejtorin e Shërbimeve Publike për përgjigjen që ma dha. Drejtoresha nuk ma dha përgjigjen e saktë ku kanë shkuar ndërsa 9106€ nga Urbanizmi më ka shqetësuar më së shumti dhe kush të mundet le të jep sqarime.

Kryetari - mjetet që janë marrë te DKA janë shpenzuar nga Asambleja Komunale për vizitën e fundit në Shqipëri pasi nuk ka pas mallra dhe shërbime.

Besa Kuçi - edukimi i vazhdueshëm profesional do të thotë që profesionistët shëndetësor që janë pjesë e QKMF-së çdo vit bëjnë vizita zyrtare jashtë vendit dhe në këtë rast kanë pas vizitë zyrtare në Shqipëri, me sa e di në emergjencën e Vlorës dhe aty mbajnë ligjëratat, marrin shkëmbime profesionale.

Liridon Fandaj - Pyetje për Drejtorinë e Financave: te projektet kapitale e shohim që nga grantet qeveritare janë shpenzuar vetëm 6.14 %. Cila është arsyeja që këto mjete nuk janë shpenzuar para të hyrave vetanake për arsye që grantet qeveritare në fund të vitit na teprojnë dhe ato shkojnë suficit ndërsa të hyrat vetanake ne mund t'i bartim prej viti në vit. A do të ishte mirë që projektet kapitale të paguheshin përmes granteve qeveritare? Te Drejtoria e Shëndetësisë janë 7950€ qiraja për ndërtesa.

Besa Kuçi - 7500€ është projekti i bonus banimit që është votuar përmes Asamblesë komunale që e paguan qeranë.

Labinot Halitjaha - granti qeveritar është shpenzuar afërsisht 56% dhe pjesa e tetorit këtu nuk është e evidentuar. Ne kemi shpenzuar shumë më shumë se që është në letër dhe nuk do të thotë që që nuk është shpenzuar granti qeveritar, që do të kthehen mjetet atje sepse komuna jonë çdo vit mbi 90% të buxhetit e ka shpenzuar dhe besoj që kemi me shpenzuar edhe këtë vit.

Selman Kolgeci - te tabela e shpenzimeve e kemi pa që më së shumti shpenzime ka për vendime gjyqësore. Sa ndikojnë këto mjete që kanë shkuar atje në implementimin e projeksionit buxhetor në vitin 2024 dhe cilat projekte kanë me na mbetur pa i realizuar?

Kryetari - planifikimi i buxhetit për këtë vit ka qenë 2.252.000. Të hyrat që mblidhen muajin nëntor-dhjetor, seancën e parë ose të dytë planifikohen dhe i sjellim në Asambleen komunale. Kam apeluar kompanitë, projektet duhet me përfunduar dhe me i bartë në fund të vitit si borgje dhe t'i regjistrojmë te zyra e thesarit dhe pas Vitit të Ri duhet me biseduar se ka i marrim dhe si i qesim këto parat. Besoj që edhe këtë sfidë e tejkalojmë. Para dy ditë kanë marrë 640.000 të investimet kapitale por ende nuk na kanë ardhë informata të sakta se sa kanë marrë mallra dhe shërbime dhe sa komunalit dhe subvencione. Punët janë duke u kryer në terren dhe të shohim ku po përfundojnë por ne e kemi obligim me i kryer projektet dhe në fund me biseduar se ku marrim dhe ndoshta ka mundësi që e bëjmë edhe një kërkesë për rimbursim prej qeverisë së RKS-së.

Alban Berisha - Kryetar atë ditë kur është mbyllur llogaria e kemi përcjellur dhe kolegët këtu kanë ngritur shqetësim dhe tani e kemi marrë lajmin që prap u rihap. Gjatë përmbledhjeve ditore që kanë qenë në lajme, a ishte politikë apo patë diçka procedurale?

Kryetari - pardje në ora 15:00 kemi marrë një njoftim përmes emailit zyrtar nga Ministria e Financave që bllokohet llogaria e Komunës së Suharekës deri sa nuk kryhen obligimet përmbartimore. Këtë është dasht me marrë para të 20-tit dhe jo në fund të muajit. Unë e kam obligim me reagu pasi ju sëbashku me mua e

kemi kalu një buxhet që është i planifikuar për këtë vit. Vitin e kaluar kur është aprovu buxheti e kam bërë një kërkesë për mundësinë që të zvogëlohen investimeve kapitale dhe të rriten pagat dhe medijtë por nuk na kanë mundur. Fondin rezervë që e përmendi ministri është vetëm për investime kapitale por nuk mund të bëhet për paga dhe medijtë. Kontratat unë jam i obliguar me i zbatu, ato që i kemi nënshkru si kuvend komunal. Këto kontrata janë të vitit 2017. Kjo punë bartet edhe vitin e ardhshëm. Këto mjete që mbesin borgj dhe nëse ne nuk marrim obligim me i kry plotësisht operatorët ekonomik me pranimin e punëve kanë të drejtë me na qu te përmbaruesi. Kontrata kolektive nuk është kontratë e imja dhe nuk është obligim i komunave por është obligim i qeverisë së RKS-së.

Alban Berisha - a je kujdes me marrë informata të sakta dhe a mund të na ndodh prap?

Kryetari - kjo ndodh me 26 apo 27 nëntor dhe ndodh edhe Vitit të Ri. Në mandatin e parë ne kemi dhënë mjete për udhëtimin por na kanë thënë që është anti ligjore. Në pjesën e dytë kemi shpall një konkurs për bartjen e mësuesave me procedura mirëpo nuk kanë dasht me shku me autobusa. Pagat jubilarë unë e di që i kemi pagu edhe te arsimi dhe te shëndetësia. Ky problem duhet të debatohet në Parlament.

Liridon Fandaj - është dasht me dal me një postim se si me i dal presionit publik sepse media nuk bën presion ndaj qeverisë dhe qeveria nuk kërkon llogari. Në KPF ZKF-ja ka thënë që programi fillor në nëntor dhe dhjetor nuk ka me pas paga. Është mirë me i përgaditë qytetarët dhe me dal me i thënë është politikë sepse kjo nuk është politikë. Kontrata kolektive u bë në 2017-tën prej Arsim Bajramit por në 2021 bashkëpartia ku yt e ka nënshkru prapë.

Kryetari - ata kanë qenë ministra e qeverisë së RKS-së dhe nuk ka të bëjë me parti politike këtu. Ti lëmë këto politika sepse ne po dëmtohem si komunë dhe buxheti i komunës po dëmtohet. Emaili zyrtar më ka ardhë prej thesarit dhe nuk ka ardhë prej përmbaruesit dhe mjetet po i merr thesari dhe ku i qon thesari është çështje e tyre. Edhe pse na kanë marrë mjetet ne kemi me bërë zgjidhje. Krejt operatorët ekonomikë kanë me marrë mjete edhe pse ndoshta me vonësë pak. Unë e mbroj intersin e të gjithë qytetarëve pa dallim partie politike.

Shefket Kolgeci - a dihet sa mjete janë marrë?

Kryetari - të fundit janë marrë prej investimeve kapitale 640.000€ dhe nuk e kemi vlerën më tutje sa kanë marrë te shërbimet dhe a kanë marrë por kur ti nxjerr financieri saktë në seancën e fundit e elaborojmë. Kryetari tutje jep sqarime.

Alban Berisha - shumë shpesh e kemi ndëgju kur është diskutu çështja e kontratës kolektive dhe paret që i merr përmbaruesi ku të don dhe nuk vet, kjo ka qenë përgjigjja juaj shpesh. Nga informatat që i kam marrë, paraprakisht para se me i marrë mjetet përmbaruesi, të qojnë kërkesë dhe të pyesin se ku do me ti marrë. Kërkoj një përgjigje.

Labinot Halitjaha - çdo vijë buxhetore e ka tavanin e vet. Kur e kanë nënshkru kontratën kolektive ata është dasht me mendu dhe me shtu vlerën e pagave, medijtëve dhe gradimit. Kur neve nuk na toleron tavani i pagave për me rrit, ata e qesin një tavan që kaq të holla ju duhen për paga. Nëse ne kishim shku me formën tjetër që të hollat m'u nda për përmbarues dhe avokat, ne e kemi një rregullore tjetër ku nuk të lejon mbi 3% të çdo vije tjetër buxhetore me i gjujt në vijë tjetër dhe ti del në auditim keq dhe humb çdo vit performancën e cila është 1 milion euro për komunën e Suharekës. Është e vërtetë që thesari 3 ose 4 ditë përpara para se me i marrë përmbaruesi, e qon një email se ku munden me i marrë të hollat dhe komuna e sheh një pjesë ku është më e lire dhe i jep përgjigjen për m'i marrë të hollat.

Liridon Fandaj - du të ndërlihem me Drejtorin e Financave që tha se po don me planifiku por ti nuk e din se çka ka me ndodh me përmbarime ose me procese gjyqësore por te pjesa tjetër e ke më të lehtë, me ja dërgu emailin thesarit dhe me i thënë që te pagat e mësimdhënësve merre sepse mësimdhënësat i rimbursen qeveria.

Kryetari - takimin e fundit që është thirrë Kryeministri i RKS-së dhe Ministri i Financave nga asociacioni i komunave, ne e kemi kërku një pikë të vetme të rendit të ditës për kontratat kolektive por s'kemi mujt me u dakordu.

Urim Suka - a kemi të dhëna se sa është obligimi për një vit që është për me përmbush kontratën kolektive. Sa mjete i duhen komunës për me përmbush kontratën kolektive. A kemi të drejtë këtë buxhet me planifiku dhe me kry për faktin se po e dime se çka po ndodh. A kemi mjete për me përmbush?

Kryetari - asnjëherë s'kemi mujt me ditë,vetëm kur të na vin te avokati i komunës lëndët përmbare dhe avokati i dorëzon te arsimi.Nuk ka mundësi Urim.Nuk ke të drejtë me kriju fond rezervë për paga dhe meditje.

Labinot Halitjaha - ti po e kërkon çfarë vlere mund të arrijë brenda vitit por këtë nuk mund ta dimë sepse nuk mund ta dime se cilët mësime kanë me kërkë gradimin sepse dikush e bën e dikush nuk e bën padinë.

Urim Suka - hiq pa e bë ata padinë,ti me pa sa paguhet për gradim një mësues dhe me i mbledh të dhënat sa mësues i ke.Sa për shujt,sa për transport dhe m'i mbledh dhe me i fut në planifikim ata dhe çdo muaj me ju dal paret.

Kryesuesi - janë afërsisht 900 mësime dhe vetëm 300 ose 400 mund të bëjnë padi.

Besa Kuçi - në 2020-tën kur e kam marrë detyrën,i kam marrë 30 ankesa prej punëtorëve shëndetësorë përmes avokatit që e kanë kërkë pagën jubilarë.E kam kërkë mundësinë te Kryetari dhe te ZKF-ja se si mundemi ne mos me i lënë me shku në përmbare dhe me ja pagu.Pjesën që kanë bë ankesë i kam lut punëtorët shëndetësor të heqin dorë nga ankesa por ata nuk kanë pranë.Kemi kërkë te pjesa tjetër që iu takojnë pagat jubilarë dhe atëherë kemi pas mundësi me i pagu për shkak se paga dhe meditje kemi pas sepse nuk kemi marrë atëherë punëtor.Pra ne duhet me rritë paga dhe meditje dhe kemi kërkë por nuk e rritin.Unë mendoj që nëse rritet paga dhe meditje atëherë ne mundemi m'i planifiku.

Pika 6. Pyetje dhe përgjigje

Aziz Bytyqi - jemi në muajin e solidaritetit dhe të gjithë e dini që Kryqi i Kuq merret me aktivitete humanitare ku tubon fonde për ndihmë njerëzve me nevojë.E kam pas një komunikim me Liridon Fandaj dhe jemi dakord që shfat e grupeve të ndajmë kohë për tu bërë pjesëmarrës në aktivitetet e Kryqit të Kuq por duke pas parasysh angazhimet e Urimit që është kandidat për deputet dhe angazhimet e Dardanit nuk e kemi qu tutje si ide.Jan tre vullnetar duke mbledh fonde jasht dhe sa të keni mundësi mundeni me dhënë.

Selman Kolgeci - kam vërejtje që ulëset këtu janë të dëmtuara dhe nuk e di a gjatë transportit apo kanë ardhë të përdorura.Dje e kam marrë një shqetësim prej një banori të fshatit Semetisht,prind i një fëmije,për mbajtjen e armës së fëmijës në shkollën në Semetisht.Kjo është shqetësuese dhe ju kisha lut drejtorit me u marrë me këtë temë dhe me u marrë edhe me organet e rendit.

Urim Suka - pyetje për Drejtorinë e Katastrës.Jam informu nga këshilli i fshatit që kanë ardhë në drejtorinë tuaj dhe kanë kërkë që pjesa e hapësirës për varreza që është nda më herët,me dal drejtorja dhe me i vendos pikat sepse po dojnë si këshill i fshatit me fillu një iniciativë për me funksionalizë atë pjesë për faktin që si komunë përtej kërkesave të shumta që unë i kam bë këtu,asnjëherë nuk keni nda buxhet për këtë çështje.Me sa jam i informuar kanë marrë përgjigje negative se ju s'keni mujt me kry këtë shërbim.A mundeni ju me kry këtë shërbim për Bllacën ?A ka rrezik që punëtorët e shërbimit publik nuk i marrin pagat për shkak të situatës që u kriju?

Armend Krasniqi - është e vërtetë që kemi pranuar kërkesë nga këshilli i fshatit të Bllacës për vendosjen e pikave kadastrale në pjesën e parcellës për varreza.Para se me ardhë në Asamble ka pas matje në teren dhe kanë qenë të vendosura pikat mirëpo shpesh fshatrat dinë mos me qenë të kënaqur por për secilën punë kërkojnë me i vendos shumë herë.Këtë çështje jemi duke e trajtu por fatkeqësisht kemi problem me aparatet e matjeve gjeodezike të cilin e kemi shpall për me ble aparat të ri por kjo lëndë ka shku në OSHP.Jemi duke komunikuar me disa gjeodet privat sepse lëndën e përgadisim ne si drejtori por gjeodetat shpesh na ndihmojnë në dalje në teren.

Urim Suka - kur ke me dal me kry këtë çështje në teren?

Armend Krasniqi - nëse na ofron asistim një gjeodet privat,sot e zgjidhim mirëpo në rast që nuk vjen,ajo parcellë ka kosto të matjes.

Jehona Rrafshi Lumi - pajtohem me ato që tha Urimi sepse shqetësimi ka qenë edhe i imi dhe dua ta di se kur do të bëhet?The që bashkëpunimi me gjeodet privat është i mirë dhe mendoj që është mundësia sa më shpejt me u kry kjo çështje.

Armend Krasniqi - ne siç thash kemi kontakte dhe bashkëpunim me gjeodet privat dhe në momentin që njëri nga gjeodetët është në gjendje të vijë,në atë moment kemi me mat.

Sheqerije Zyrapi - për shkak të ndërtimeve që janë duke u bërë në rrugët “Adem Kuçi,Milit Kryeziu,Garibaldi,Tranziti i ri,Migjeni”,këto rrugë janë të dëmtuara nga makineritë e rënda.Kush është përgjegjës për me i rregullu dhe kur do të ndodh?A do të hyjë në funksion ndriçimi te sheshi Besim Ndreca? Kur do të bëhet zgjidhja e parkingjeve për banorët rezidentë në ndërtesat kolektive?Kam marrë përgjigje më herët nga Kryetari por tregu që është për me shku banorët,a munden me shku personat tjerë që vin me i kry obligimet e tyre dhe banorët rezidentë me pas një parking sepse marrin denime çdo herë nga policia.

Kryetari - ato besoj që në vitin e ardhshëm një pjesë e ndërtimeve të larta përfundon,Është në projekt heqja e kubëzave,kanalizimi që ka me u lidh prej lagjes së Gashve dhe besoj bëhet renovimi i komplet asaj pjese.Sa i përket ndriçimit besoj shumë shpejt sheshi Besim Ndreca duhet me u rregullu dhe parkingjet në momentin që krijohen fushat e sportit,ato parkingje kanë me qenë për ata qytetarë.

Shefket Kolgeci - disa fermerë kanë ngrit shqetësim shkaku që është shfaq një sëmundje tek bagëtia e tyre,TBC dhe dikujt ju kanë ngordh 4-5 bagëti.A ka informata në këtë aspekt?A ka ndihmë për këta fermerë?

Ardian Kotorri - po jemi të informuar për këtë shqetësim dhe nuk është vetëm në komunën tonë por edhe më gjerë,Sa kam informacion,agjensia e veterinës dhe ushqimit është duke u marrë me këtë çështje dhe kanë me u konpenzu në fund për ato bagëti të cilat konsiderohet që kanë pas dëmtime apo ka ardhë si pasojë ngordhja e tyre prej kësaj sëmundje.

Shefket Kolgeci - a ka mundësi Drejtoria e Bujqësisë me iu ndihmu këtyre fermerëve?

Ardian Kotorri - ne e kemi pas një fond emergjent deri në 2021 dhe prej viti 2022 nuk ka fond emergjent asnjëri prej dikasterëve të komunës dhe është problem me gjet formë për me i mbështet. Me pas mundësi prej kategorisë së subvencioneve në janar por është e vështirë.

Liridon Fandaj - janë tri rrugë në Peqan që janë tenderu dhe veq në njërin rrugë kanë fillu punimet dhe aty vetëm një kamion zhavor ka ardhë.Kur kanë me përfundu punimet dhe a do të ndodh që vitin tjetër me vazhdu me këto Punime?Pyetja tjetër që e bëri Dr.Kolgeci për Drejtorin e Bujqësisë,është shqetësuese sepse si sëmundje është përhap në shumë fshatra.Ata kanë fillu me i gropos afër pronave të veta dhe mos po ndodh një epidemi më e madhe për shkak të sëmundjes që ende nuk ka dal dikush me një vendim zyrtar se cila është sëmundja.

Enver Shabani - në Peqan është e vërtetë që kemi kriju tender dhe afati për përfundimin e punimeve është 90 ditë.Nuk kemi asnjë obligim ndaj asaj kompanie dhe ata nuk kanë arsye m'u ndal dhe punët duhet me përfundu brenda 90 ditëve.

Ardian Kotorri - sa kam informacion realisht ata janë duke u marrë.Ka qenë edhe një rast tjetër në fshatin Sopijë me sëmundjen e bletëve dhe edhe aty u marrë agjensia e veterinës dhe ushqimit.

Liridon Fandaj - çështja për punë të groposjes,do të duhej të ishte një lokacionDrejtoria nuk e cakton lokacionin.Nëse ka bagëti dhe e gropos në pronën e vet,kjo do të jetë rrezik për qytetarët.

Ardian Kotorri - aktualisht kaq mund të them.

Alban Berisha - Kryetar duke u ngrit niveli i sportit ngritet edhe nivelei e sportistave që marrin pjesë në klubet tona.Unë jam afër atyre,jo që jam ndonjë faktor por prej dashnisë për sportin dhe e di që shumë shpesh ka lojëtar që refuzojnë me lu shkaku i kushteve që janë në palestër.E di që një gjë e mirë ka ndodh me aneksin por nuk është mjaftueshëm.Dua ta ndërlihd edhe drejtorin e Shërbimeve publike se çfarë masa munden me u marrë që edhe seancat stërvitore me qenë të paktën me pak nxemje sepse lojëtarët e huaj nuk e kanë atë ndjenjën tone.Është mirë me bo një koordinim më të mirë të termineve të shfrytëzimit të palestrës sportive.Ka ankesa prej lojëtarëve dhe prej stafit që është e pamundur me i bo stërvitjet në ato kushte.Fatkeqësisht kemi pas raste kur nuk është luft loja sepse temperaturat kanë qenë nën kushtet e lejuara prej federates së basketbollit.Nxemja e di që ka shpenzime sepse aty është me naftë.Ju Kryetar jeni në dijeni për një projekt me DEMOS që njëra prej komunave përfituese jemi edhe ne dhe kërkohet që trajnimi me u mbajtë për zyrtar komunal dhe asambleist dhe nuk ka arrit me u mbaj,dhe ne jemi përfitues.Kam dëshirë me qenë ma sy qel,më të organizuar që sidomos për institucionet me fitu projekte solare,me nxemje alternative dhe jo më me shku me pelet dhe me naftë.

Kryetari - kemi mbajtur trajnime me USAID ,DEMOS dhe me GIZ gati çdo javë dhe sa i përket sallës sportive ke të drejtë dhe është mirë me të bë një projekt dhe me konkuru por konkursi më shumë është për privat.Ne jemi në marrëveshje me Kryetarin e Federates së Basketbollit të RKS-së ku ai ka thënë që do të mundohet me nda një fond 4.5 por më tutje kemi problemin e pronës ku e ndërtojmë atë sallë sportive.

Bulëza Kuçi - e dini që në KPF e kam hap si diskutim çështjen e byfësë në shkollën “Destan Bajraktari”.Është çështje delikate ku rrezikohen fëmijët çdo ditë aty dhe përveq rrezikshmërisë së jetës së tyre edhe me vonesë po arrijnë me fillu mësimin pas pushimit të gjatë.Shkolla ka bërë disa kërkesa që besoj ju i keni të deponuara dhe atë ditë nënkryetarja ma dha fjalën që do ta kthejë një përgjigje me shkrim ndërsa drejtoresha më tha që ka bisedu me Kryetarin ku i ka thënë që mund të vazhdojë procedurat me këshillin drejtues të shkollës.Pse nuk po na kthen një përgjigje me shkrim që ta kemi si bazë se si m'i vazhdu procedurat? Pse nuk po rregullohet parkingu te shkolla “Destan Bajraktari” ?

Kryetari - e kam bisedu problemin që ceke por kur është objekti brenda shkollës,nuk ka nevojë me shku përmes Asamblesë komunale dhe e vendos bordi i shkollës.

Bulëza Kuçi - ne si shkollë po e kërkojmë një përgjigje me shkrim.

Nënkryetarja - unë vërtetë e mora përsipër me ta kthyer një përgjigje dhe menjëherë kam bisedu edhe me Kryetarin dhe Drejtorin e Arsimit dhe kërkesa juaj ka qenë shumë e arsyeshme dhe jemi të interesuar që byfeja të kthehet.

Remzi Bajselmani - po e kemi bisedu dhe kemi mendu që ofertimin me të bordi i shkollës dhe nuk kemi kthyer letër sepse na ka dalë një problem që nuk dimë si ta bëjmë gjyrollogarinë e shkollës sepse shkollat nuk kanë gjyrollogari.Jemi në kërkim të zgjidhjes për gjyrollogarinë ose duhet ti caktohet komunës.

Qëndrim Elshani - a ka kontratë operatori që e menaxhon tregun?

Armend Kasniqi - po ka kontratë.

Qëndrim Elshani - a ka obligime ndaj komunës dhe a keni marrë ndonjë masë?

Labinot Halitjaha - ne të gjithë vërejtjet ia kemi dërgu operatorëve që i kanë obligime komunës.Përfundimisht ata obligues tatimor që kanë obligime tatimore ndaj komunës,që kanë shfrytëzuar pronën komunale,javën tjetër do i dëgojmë në përmbarues.

Qëndrim Elshani - secili operator që nuk i kryen obligimet duhet me iu shkëput kontrata.A keni marrë masa jo vetëm ndaj tij por edhe ndaj plot tjerëve që nuk i kanë kry obligimet?

Labinot Halitjaha - obligimi im është me u marrë me çështet financiare dhe jo shkëputjen e kontratave.

Urim Suka - këtu përball nesh,pas muzeut dhe fushës së futbollit është një gjendje ku kalojnë prind e sportdashës dhe aty situata është tmerruese .Pse është ashtu ose pse nuk zgjidhet dhe kur pritët të zgjidhet?

Kryetar - është një projekt tjetër që do të mundohet me u ndryshu dhe të shohim.